

HULUMTIM: KEQPËRDORIMI I PRONËS INTELEKTUALE

# MBRETËRIA E "PIRATËVE"

Pirateria ka pushtuar çdo pore të Maqedonisë. Në të gjitha fushat e produksionit intelektual "punktet" e falsifikimeve mbeten të pranishme. Pirateria po përhapet kudo, ngjashëm me tumorin në fazën e metastazës. Nuk ka qytet apo fshat të Maqedonisë ku nuk shiten materiale pirate. Mbrojtja e pronës intelektuale është sanksionuar me ligj, por deri më tani shumë pak persona-shpërdorues janë përballur me ligjin. Specialistët e kësaj fushe thonë se ky lloj krimi është mirë i organizuar. Sipas tyre, fitimet nga pirateria janë marramendëse, ndërsa humbjet e shtetit kapin vlerën e rreth 45 milionë eurove në vit. Zinxhiri i piraterisë mbetet i sofistikuar, ndërsa hierarkia mirë e organizuar. Pjesa më e madhe e piratëve është e organizuar aq mirë sa që i kalon kufijtë e Maqedonisë, ndërkaq ka edhe grupe të vogla që punojnë vetëm

**BARDHYL ZAIMI-URIM HASIPI**

Në çdo cep të rrugës, në çdo kohë, shitësit e materialeve pirate mund t'i gjejsh aty, të përçqendruar në "biznesin" e tyre. Gjithmonë të gatshëm të të ofrojnë informacion për atë që dëshiron të blesh, për këngëtarët dhe për filmin më të ri të "ofertës" së tyre. Gjithnjë një stivë CD-sh, DVD-ish dhe kasetash të filmave më të ri ekspozohen në vendet më të frekuentuara dhe për më pak se 2 euro një kopje pirate mund të jetë pronë e të interesuarve.

Janë tezgaxhinj rrugësh, në të shumtën e rasteve hallexhinj, për të cilët mbrojtja e pronës intelektuale mbetet një nocion i largët, i kapshëm si "kërcënim" vetëm atëherë kur policia ndërmerr aksion për sekuestrimin e materialeve pirate të tyre. Shumica nga ta, materialet pirate i sigurojnë nga të tjerë persona, identitetin e të cilëve në asnjë rast nuk e zbulojnë, nga se kanë frikë se e humbin "bukën e gojës". "Me këtë punë e sigurojë familjen time dhe nuk shoh asgjë të keqe këtu", thotë një shitës i materialeve pirate në Tetovë, i cili kërkon të mbetet anonim. Pasi shqipton këto fjalë, qetësisht fut duart në xhepat e xhakëtës dhe me sy të trembur të sinjalizon se çdo bisedë e mëtejshme është e tepërt. Në të shumtën e rasteve këta shitës "mbijetese" mbeten të shkëputur nga zinxhiri i këtij "biznesi" fitimprurës përmes një pakti të heshtur që iu sugjerohet nga furnizuesit e studiove pirate. Në "hierarkinë" e këtij zinxhiri enigmatik nuk ka pyetje, por vetëm shërbim.

Tregu pirat i artit ka pushtuar çdo pore të Maqedonisë. Ai përhapet kudo, ngjashëm me tumorin në fazën e metastazës. Nuk ka qytet apo fshat të Maqedonisë ku nuk shiten materiale pirate. Mbrojtja e pronës intelektuale është sanksionuar me ligj, ndërkohë që specialistët thonë se ky lloj krimi është mirë i organizuar. Specialistët e kësaj fushe thonë se fitimet nga ky lloj krimi i organizuar janë marramendëse, ndërsa humbjet e shtetit kapin vlerën e rreth 45 milionë eurove në vit. Materiale pirate mund të gjejsh gati edhe në çdo videotekë të Maqedonisë. Pjesa më e madhe e piratëve është e orga-

nizuar aq mirë sa që i kalon kufijtë e Maqedonisë, ndërkaq ka edhe grupe të vogla që punojnë vetëm. Edhe pse materialet pirate shiten kudo dhe disa herë janë ndërmarrë aksione për ndalimin e tyre, përsëri në çdo cep të rrugës vazhdon prania e tyre. Kopjimi i një CD-je apo hedhja e një programi, nga një kompjuter në një tjetër, ndodh në mes të ditës, pa asnjë problem. Vështirësia për të kopjuar një film apo muzikë në internet është thuarse zero, pasi programet janë të gatshme dhe mund të vidhen e pastaj të shpërndahen ilegalisht. Gjatë 17 viteve të tranzicionit ky lloj biznesi ka hedh shtat dhe tani vështirësitë e ndalimit të tij janë shtuar.

**Si punojnë piratët?**

Ka dy lloj grupesh të piratëve të filmave dhe të CD-ve. Në grupin e parë, që konsiderohen më pak të rrezikshëm nga inspektorët e piratërisë, por që e "pëson" më shumë nga policia bëjnë pjesë persona që punojnë vetë ose në grupe të vogla prej 3-4 personave. Ata i incizojnë DVD dhe CD në shtëpi dhe më pas i shesin në rrugë për një çmim tepër të lirë. Një të tillë takuam edhe në Shkup, në një tezgë të vogël afër bit Pazarit. Ky shitës emri i të cilit është i njohur për autorët e këtij teksti thotë se i incizon vetë CD-të dhe filmat që i shet. "Jam i papunë dhe më duhet që të mbaj familjen. Kam gruan dhe tre fëmijë. Ç'të bëj? Më parë i incizoja CD-të te një miku im që kishte kompjuter, ndërsa më pas bleva vetë një kompjuter dhe aty incizoj. Unë nuk kam shumë fitime, vetëm sa për të mbajtur gjallë familjen", thotë ai.

Lëvizjet i ka të ngadalshme dhe shikimin e ka të defokusuar në një përhumbje matanë pranisë sonë, e cila duket se i pengon. Me gishtat e mbufatur rregullon disa DVD të këngëtarëve, "zhanret" e të cilëve tashmë i ka mësuar përmendsh. Pas pak ai kridhet në një "trishtim" të brendshëm dhe në pozicion keqardhje sa për të vërtetuar atë që e thotë me plot vështirësi dhe me zë të mekur: "Vetëm sa për të mbajtur gjallë familjen". Ky "refren" mund të dëgjohej te secili shitës rrugë, të cilët në të shumtën e rasteve paraqiten si një kategori njerëzish asocial dhe në kufijtë e



mbijetesës.

Ndërsa grupi tjetër, që konsiderohet si më i sofistikuar nga inspektorët e tregut pirat është i organizuar mirë dhe ka rrjetin e vet. Drejtori i Trupit Koordinues për mbrojtjen e pronës intelektuale, Mite Kostov thotë se në studiot pirate të vendosura në objekte banimi në Manastir, Ohër dhe Shkup, kanë punuar dhjetëra persona të lidhur me njëri tjetri. Sipas tij, makineria e zënë në Strumicë për incizimin e filmave ka nxjerrë në sipërfaqe përfshirjen e një grupi personash nga më shumë shtete të botës. "Ata kanë ecur shumë përpara nesh. Në biznesin e tyre nuk ka dallime nacionale e fetare", thotë Kostov.

**Vetëm një botues ka gjetur 18 vepra të tij të riprodhuara**

Edhe pirateria e librit "qarkullon" në të njëjtat labirinte si pirateria e CD-ve dhe DVD-ve. Librat artistik, lekturat dhe librat universitarë riprodhohen e fotokopjohen kudo. Në të gjitha fotokopjet pranë universiteteve librat e nevojshëm për studentët fotokopjohen si skripte. Pronari i Shtëpisë Botuese "Vatra", Halil Zendeli thotë se 17-18 botime të tij i ka gjetur të riprodhuara në Tetovë, Dibër e Kërçovë, por edhe në Panairin Ndërkombëtar të Librit që mbahet në Shkup. "E marrin botimin tim të gatshëm, i vënë librit kopertina të tjera, ndërsa brenda e lënë logon e 'Vatres'. Kështu më ka ndodhur me 17-18 tituj", thotë ai. Zendeli sqaron se më parë ka bërë disa anketa në lidhje me këtë çështje, por meqë nuk ka arritur asnjë rezultat ka hequr dorë nga kjo punë. "Veç këtij lloji të piraterisë ka edhe një lloj tjetër të vjedhjes së botimeve. Botimi yt shërben si model. P.sh. shkrimtarët e traditës, aty nuk respektohen disa audience të të drejtës së autorit, mirëpo ai kërkon punë. Së pari duhet të bëhet zgjedhja, duhet të redaktohet, të lekturohet, etj. Dhe ai, botuesi tjetër, nuk e bën zgjedhjen por e merr të gatshme. E merr librin tim

e fotokopjon dhe e boton në emër të shtëpisë së tij botuese", sqaron Zendeli.

Nga Sektori i të drejtave të autorit sqarohet se në këtë rast janë shkelur dyfish edhe të drejtat e autorit edhe të drejtat e botuesit. Por, megjithatë gjysmën e fajit përsëri ia hedhin vetë autorëve ose botuesve. "Neve na kanë mbetur disa vese nga komunizmi. Gjithmonë presim që qeveria të na i garantojë të drejtat tona. Së pari, vetë duhet të kërkojmë të drejtën tonë, edhe pse dihet që gjykatat punojnë shumë avash, por megjithatë drejtësia është drejtësi", thotë udhëheqësja e këtij sektori, Olgica Trajkovska. Ajo sqaron se deri në nëntor të vitit të kaluar një shërbim inspektorial i Ministrisë së Kulturës ka punuar në terren në lidhje me shkeljet e të drejtave të autorëve. Ky shërbim ka pasur vetëm tre inspektorë, të cilët nuk kanë gjetur asgjë në terren.

Kohë më parë, Shoqata e librarive të Maqedonisë ka reaguar ndaj shitjes jolegale të librave shkollor. Kjo shoqatë ka kërkuar që të hiqen të gjitha tezgat nga trotualet dhe pazaret e qyteteve, si dhe libreria e hapur afër shëtitores pranë lumit Vardar në Shkup, ku bëhen shitje masive të librave shkollor dhe materialeve tjera shkollorë. Kryetari i kësaj shoqate, Gjorgji Simevski ka kërkuar nga shteti mbrojtje nga ky lloj i konkurrencës jolegale, nga se kjo shoqatë mbush buxhetin e shtetit, ndërkohë që, sipas tij, konkurrenca jolegale e vjedh shtetin. Duke u thirrur në ligjin për mbrojtjen e të drejtave autoriale dhe mbrojtjen e pronës intelektuale, si dhe në luftën kundër piraterisë me librat shkollor kjo shoqatë ka kërkuar ndalimin e fotokopjeve të librave shkollor. (vazhdon)

(Hulumtimi është realizuar me mbështetjen e projektit SCOOP dhe Shoqatës daneze të Gazetarëve Hulumtues)

NË GOSTIVAR

## Italianët ndërtojnë deponi regjionale

Pas gjashtë muajve, sërish Komunën e Gostivarit e vizitoi konsulli i nderit të RM-së në Milano të Italisë Ticiano Meoli me bashkëpunëtorët e tij, të cilët u pritën nga kryetari i Komunës së Gostivarit Nevzat Bejta. Derisa investitorët italian para gjashtë muajve, ishin të interesuar për mundësitë që të investojnë në Gostivar, ata kësaj here erdhën me projekte konkrete për investim, për ndërtimin e fabrikës regjionale për riciklimin e mbeturinave. "Ne u garantuam që administrata e Komunës së Gostivarit, do të jenë në shërbim të kërkesave të tyre", tha kryetari i Komunës së Gostivarit Nevzat Bejta.

"Në bashkëpunim mes pushtetit lokal dhe atij qendror, konkretisht me Ministrinë e Ambientit Jetësor do të ndërtojmë fabrikën për riciklimin e mbeturinave, gjë që është shumë e kërkuar nga qytetarët e Gostivarit. Ju thash edhe mysafirëve, se dy gjëra janë kërkesa kryesore të qytetarëve të Gostivarit. Ndërtimi i stacionit filtrues që qytetarët e Gostivarit të pinë ujë të freskët dhe ndërtimi i fabrikës, ashtu siç janë ndërtuar për riciklimin e mbeturinave nëpër qytetet e vendeve të Bashkësisë Europjane", deklaroi Bejta.

**DONACIONE GJERMANE PËR SPITALIN E KUMANOVËS**

## Dhjetë aparate për dializë

Me 12 gusht, janë sjellur dhjetë aparate për dializë me një vlerë prej 150 mijë euro. Aparatet kanë aritur në spitalin e përgjithshëm të Kumanovës, në repartin e Neurologjisë. Donacioni që vjen nga Gjermania respektivisht nga spitali KFH-Kuratoriumi Fur Dialyse Nieren Plantation, nëpërmjet shoqatës Humanitare "Nëna Tereza" do të zbusë sadopak gjendjen e të sëmurëve me dializë në qytet. Ishte mjeku Shukri Fazliu, i cili që një vit më parë duke parë gjendjen e mjerueshme të pacientëve që vuajnë nga kjo sëmundje kërkoi ndimë nga Gjermania.

"Pacientët përballeshin me kushte shumë të vështira. Aparatet e vjetra të cila prisheshin herë pas herë dhe i lënë pacientët në meshirë e fatit ishte një shkasë për të më shtynë për të kërkuar ndimë, veç asaj që edhe profesioni e kamë fuman, tha Fazliu. Reparti i Nefrologjisë në spitalin e Kumanovës ka gjithsej 15 aparate për dializë, të cilët janë më të vjetër se 20 vjetë. Brenda vitit spitali KFH - Kuratoriumi Fur Dialyse Nieren Plantation do ti dhurojë këtij spitalit edhe 25 aparate të tjera për dializë. Dhjetë aparatet e dializës që kanë aritur në Kumanovë që 14 ditë do të instalohen mbrenda muajit gusht. (M.Th.)